



Merren masa për punëdhënësit privatë me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në Shqipëri

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka urdhëruar marrjen e masave të ndryshme, për kategori të ndryshme punëdhënësish privatë, si më poshtë:

A Detyrime për subjektet private që ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtar si bare, restorante, klube nate, palestra

Më datë 11.03.2020, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka njoftuar një urdhër të ri ("**Urdhri i ri**"), specifik për Tiranën dhe Durrësin, i cili parashikon:

- Mbylljen e aktivitetit për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtar si bare, restorante, klube nate, në Tiranë dhe Durrës, deri në një njoftim të dytë.
- Gjobën prej 2,000,000 (dy milionë) lekësh, për mosmarrjen e masave të nevojshme për zbatimin e urdhrit të mësipërm, apo për rihapjen e aktivitetit në kundërshtim me sa përcaktohet në këtë urdhër.

Ndërkohë, rikujtojmë se Ministria e Shëndetësisë, me urdhrin nr. 156, datë 10.03.2020 "*Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19*" ("**Urdhër 156**"), ka parashikuar për të gjithë vendin:

- Mbylljen deri më datë 03.04.2020 të:
 - Ambienteve që ofrojnë shërbim lokale nate;
 - Ambienteve të mbyllura të dedikuara për argëtimin e fëmijëve dhe të rinjve;
 - Aktivitetin në palestra, qendra sportive, pishina;
 - Aktivitetin në qendra interneti;
 - Aktivitetin në qendra kulturore dhe qendra argëtimi.
- Ushtrimin e aktivitetit të bareve, restoranteve, lokaleve, vetëm duke respektuar:
 - Distancën prej së paku dy metrash nëpërmjet tavolinave në vendet ulur;
 - Distancën prej së paku një metër të njeriut nga njeriu.

Masat janë shtrirë edhe në Elbasan, ku Bashkia ka urdhëruar:

- Mbylljen e aktivitetit për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtar si bare, restorante, klube nate.

B Detyrime për punëdhënësit dhe subjektet private që nuk bëjnë pjesë në kategorinë A më sipër

Urdhri 156 dhe Urdhri i Ri, kanë parashikuar:

- **Ndalimin deri në datë 3.04.2020 të:**
 - Procedurave të konkursit për punësim personeli.
- Detyrimin për institucionet private për të hartuar brenda datës 11.03.2020, një plan masash për sigurimin e ofrimit të shërbimeve prioritare, duke priorizuar kategorinë e shërbimit kryesisht nëpërmjet ofrimit të shërbimit online, punës në distancë dhe vetëm në raste të domosdoshme të ofrojnë shërbimin nëpërmjet kontaktit fizik.



- Për të gjitha bizneset dhe punëdhënësit privatë që nuk mund të mbyllen për arsye të zinxhirit ekonomik, detyrimin për marrjen e masave për vendosjen e distancës së sigurisë mes punonjësve, prej 1.5 metra dhe për pajisjen e punëmarrësve me mjete pune mbrojtëse me qëllim ruajtjen e shëndetit të tyre.
- Për bizneset Call Center, detyrimin për të reduktuar në maksimum personelin në ambientet e punës dhe marrjen e masave të duhura për garantimin e distancave dhe të kushteve mbrojtëse për çdo punonjës.

C Detyrime për subjektet private që ushtrojnë aktivitet në fushën e transportit

Urdhri i Ri ka parashikuar:

- Ndalimi i qarkullimit të mjeteve të transportit publik dhe privat, përfshirë automjetet private, brenda Tiranës dhe Durrësit dhe nga Tirana dhe Durrësi drejt zonave të tjera të vendit dhe anasjelltas, duke filluar nga ora 06:00 e datës 13.03.2020 deri në orën 24:00 të datës 15.03.2020.
- Ndalimi i qarkullimit të mjeteve të transportit publik dhe privat, përfshirë automjetet private, në Shkodër, Lezhë, Elbasan, Lushnje, Fier dhe Vlorë duke filluar nga ora 06:00 e datës 13.03.2020 deri në orën 24:00 të datës 15.03.2020.
- Përrjashtim nga rregulli i mësipërm bëhet për automjetet që transportojnë mallra.

Ky dokument behet vetëm per qëllime informative. Nuk përbën këshillë ligjore dhe / ose angazhim te cdo lloj natyre. Per çdo sqarim ju lutem kontaktoni: **tax_legal-alko@deloittece.com**



Measures are taken for private employers to prevent the spread of COVID-19 infection in Albania

The Ministry of Health and Social Protection has ordered different measures for different categories of private employers, as follows:

A Obligations for private entities exercising their commercial activity as bars, restaurants, nightclubs, gyms

On 11.03.2020, the Ministry of Health and Social Protection has announced a new order ("**New Order**"), specific to Tirana and Durrës, which provides:

- Closing of the activity for all entities that exercise their commercial activity as bars, restaurants, night clubs, in Tirana and Durrës, until further notice.
- A fine of ALL 2,000,000 (two million) for failing to take the necessary measures to comply with the above order, or for reopening their activity contrary to the provisions of this order.

Additionally, we remind that the Ministry of Health, by order no. 156, dated 10.03.2020 "*On special measures to prevent the spread of infection caused by COVID-19*" ("**Order 156**"), has provided for the entire country:

- Closing until 03.04.2020 of:
 - Facilities that provide night club services;
 - Indoor facilities dedicated to entertaining children and youth;
 - Activity of gyms, sports centers, swimming pools;
 - Activity of internet centers;
 - Activity of cultural and entertainment centers.
- Bars, restaurants, coffee shops shall exercise their activity only by respecting:
 - A distance of at least two meters between tables in sitting areas;
 - The distance of at least one meter between individuals.

The measures have been extended to Elbasan city, where the Municipality has ordered:

- The closing of the activity for all private entities that exercise their commercial activity as bars, restaurants, nightclubs.

B Obligations for employers and private entities not included in category A above

Order 156 and the New Order provide:

- **Prohibition until 3.04.2020 of:**
 - Staff recruitment competition procedures.
- Obligation for private institutions to draft within 11.03.2020 a plan of measures to ensure the provision of priority services, prioritizing the category of service primarily through online service provision, teleworking and only when necessary to provide service through physical contact.



- For all businesses and private employers that cannot close their activity as a result of sustaining the economic chain, they must take measures to establish a safety distance between employees of 1.5 meters and to provide employees with protective equipment in order to maintain their health.
- For Call Center businesses, the obligation to reduce as much as possible the staff in the workplace and to take appropriate measures to guarantee the distances and protective conditions for each employee.

C *Obligations for private entities operating in the field of transport*

The New Order provided:

- Prohibition of public and private transport, including private vehicles, within Tirana and Durrës and from Tirana and Durrës to other areas of the country and vice versa, starting at 06:00 on 13.03.2020 until 24:00: 00 dated 15.03.2020.
- NProhibition of circulation of public and private transport, including private vehicles, in Shkodra, Lezha, Elbasan, Lushnje, Fier and Vlora starting from 06:00 on 13.03.2020 until 24:00 on 15.03.2020 .
- Vehicles transporting goods shall be an exception to the abovementioned rules.

This document is delivered for informative purposes only. It does not constitute legal/tax counsel and/or commitments of any nature. For any further clarification please contact:

tax_legal-alko@deloittece.com